

ADMINISTRATA TATIMORE Plani Strategjik 2017 - 2021



DREJTORIA E
PERGJITHSHME
E TATIMEVE

PËRMBAJTJA

PJESA 1 – Hyrje	4
PJESA 2 – Objektivat Strategjikë dhe arritja e tyre	6
Objektivi Strategjik 1:	6
Objektivi Strategjik 2:	7
Objektivi Strategjik 3:	8
PJESA 3 – Treguesit kryesorë të performancës	10
Aneksi 1 - Treguesit kryesorë të performancës	10
Aneksi 2 - Lidhja e objektivave me rekomandimet e TADAT	11
Aneksi 3 - Lidhja e planit strategjik me buxhetin.	17

PJESA I

Hyrje

Administrata Tatimore Qendrore është një autoritet shtetëror i specializuar, në varësi të Ministrit të Financave për krijimin, sigurimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Vizioni:

Një Administratë Tatimore moderne dhe efikase në shërbim të shoqërisë, për të garantuar një nivel të lartë të transparencës dhe moderizimit të shërbimeve, duke u bërë një burimi kryesor i të hyrave për shtetin Shqiptar.

Misioni:

Administrata Tatimore Qendrore administron mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontributeve shoqërore, duke nxitur përmbushjen vullnetare dhe duke kërkuar nga të gjithëkuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore.

Parimet dhe vlerat:

Punonjësit e Administratës Tatimore Qendrore luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen e qëllimeve të Administratës dhe në ruajtjen e integritetit të saj.

Administrata Tatimore Qendrore synon rritjen e besimit publik, nëpërmjet zhvillimit dhe garantimit të një kulture organizative të bazuar në parimet e mëposhtme:

- » Zbatimi i ligjit, barazia dhe drejtësia;
- » Përgjegjësia, ndershmëria, transparenca;
- » Efektiviteti, efikasiteti, besueshmëria.

Gjatë zbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore, Administrata Tatimore Qendrore bazohet në standarde të larta të sjelljes dhe vlerave themelore, të tilla si:

- » Shërbimi cilësor;
- » Ndershmëria dhe besimi;
- » Motivimi dhe zhvillimi i potencialit njerëzor;
- » Puna në grup dhe fryma bashkëpunuese.

Nëpunësit e Administratës Tatimore Qendrore në punën e tyre të përditshme janë përgjegjës për zbatimin e këtyre vlerave dhe me sjelljen e tyre ndikojnë drejtpërdrejtë në imazhin e saj. Zbatimi i këtyre parimeve dhe vlerave është një faktor kyç në të gjitha aspektet e funksionimit të Administratës:

Për institucionin

- » Në kapacitetin e saj si një autoritet ekzekutiv në nivel qendror;
- » Në kapacitetin e saj si një punëdhënëse;
- » Kur ndërveprojnë me klientët dhe përfaqësuesit e tyre;
- » Kur ndërveprojnë me palët kryesore të interesuara.

Për punonjësit

- » Gjatë ndërveprimit me klientët dhe përfaqësuesit e tyre;
- » Gjatë ndërveprimit me njëri-tjetrin;
- » Në çdo veprim individual që ata bëjnë, të cilat mund të ndikojnë në administratën tatimore qendrore dhe reputacionin e saj.

Integriteti në Administratën Tatimore Qendrore garantohet me anë të standardeve etike të sjelljes, prioriteteve dhe planeve vjetore, menaxhimit financiar dhe kontrollit, menaxhimit të sigurisë së informacionit, kontrollit të performancës dhe vlerësimit, auditimit të brendshëm, dhe komisioneve disiplinore.

Synimet Strategjike

Administrata Tatimore Qendrore synon që në jetën sociale dhe ekonomike të vendit të sigurojë të ardhurat për financimin e politikave sociale dhe zhvillimin e qendrueshëm.

Administrata Tatimore Qendrore krijon kushtet e nevojshme për qytetarët dhe bizneset, që të kuptojnë detyrimet e tyre ligjore dhe t'i përmbushin ato lehtësisht me kosto minimale.

Administrata Tatimore Qendrore mbron stabilitetin ekonomik të vendit dhe qytetarëve duke identifikuar tatimpaguesit të cilët nuk i përmbushin detyrimet e tyre ligjore, si dhe duke ushtruar të gjithë forcën e ligjit kundrejt këtyre tatimpaguesve.

Objektivat dhe masat për zbatimin e misionit të Administratës Tatimore Qendrore, mbështeten në bindjen se përmbushja vullnetare mundësohet vetëm atëherë kur të gjitha funksionet për shërbimin ndaj klientit, kontrollit tatimor dhe mbledhjes së detyrimeve të prapambetura do të trajtohen si një tërësi veprimesh të ndërvarura dhe të mbështetura në modelin e menaxhimit të riskut.

Administrata Tatimore Qendrore merr pjesë në mënyrë aktive në Komitetet që zhvillon Komisioni Evropian në lidhje me tatimet.

Synimet strategjike të Administratës Tatimore Qendrore për sa i përket burimeve njerëzore dhe ripërtëritja e teknologjisë informative për të mundësuar punë më efikase dhe shërbime të përmirësuara për tatimpaguesit.

Së fundmi, ky Plan Strategjik ka për qëllim arritjen e efikasitetit maksimal nëpërmjet qendrueshmërisë së menaxhimit dhe përshtatjes së procedurave ekzistuese, bazuar në ndryshime minimale organizative.

Administrata Tatimore Qendrore është përgjegjëse për të siguruar besimin e shoqërisë mbi sistemin e të ardhurave. Në mënyrë që ajo të kryejë me sukses funksionet e saj, të gjithë punonjësit e Administratës Tatimore Qendrore duhet të sillen sipas parimeve, vlerave dhe standardeve të larta të deklaruara nga Administrata.

Modeli i përmbushjes vullnetare përbën themelin e këtij plani strategjik. Ky model është një qasje e strukturuar për t'i mundësuar Administratës Tatimore Qendrore të përdorë dhe menaxhojë faktorët që ndikojnë në sjelljen e tatimpaguesve për sa i përket pajtueshmërisë të detyrimeve të tyre në përputhje me kuadrin ligjor fiskal.

Sjellja e tatimpaguesve ndikohet nga faktorë të shumtë ekonomikë, socialë dhe psikologjikë, ku këta të fundit lidhen shumë edhe me vetë kulturën, e cila përfshin sjelljet e mësuara, besimet, pikëpamjet, vlerat dhe ideat që janë karakteristika e një shoqërie apo e një popullate të caktuar ku tatimpaguesi ushtron aktivitetin e tij. Gjithashtu modeli i përmbushjes influencohet ndjeshëm edhe nga mjedisi specifik i biznesit në të cilin bashkëvepron me klientët, furnitorët, kreditorët, bankat, vetë entet publike, etj.

Qëllimi i aplikimit të modelit të përmbushjes ka për objektiv dhe synon rritjen e numrit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet, të cilët vendosin vullnetarisht, në përputhje me legjislacionin tatimor, të regjistron si tatimpagues në Republikën e Shqipërisë, si dhe të njohin e të zbatojnë legjislacionin e kërkuar tatimor.

Përzgjedhja e instrumenteve të përshtatshme për trajtimin e risqeve, si dhe të kuptuarit e arsyeve se pse grupe të caktuara të tatimpaguesve nuk janë në përputhje me legjislacionin tatimor dhe të kontributeve shoqërore, do mundësojë administratën të përdorë dhe përqendrojë burimet e saj në mënyrë efikase. Kjo është arsyeja pse Administrata po vendos në funksionim Menaxhimin e Riskut si një model të nxitjes së pajtueshmërisë me legjislacionin tatimor dhe kontributet shoqërore, por edhe identifikimin e rasteve potenciale të cilat përbëjnë risk lidhur me konkurrencën e ndershme dhe trajtimin e barabartë.

Treguesit e performancës janë zhvilluar për të vlerësuar zbatimin e Planit Strategjik.

PJESA 2

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE ARRITJA E TYRE

Objektivi Strategjik 1:

Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare

Nën objektivi 1.1.

Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore.

- » Mirëmbajtja dhe zhvillimi i shërbimeve që i korrespondojnë teknologjisë moderne dhe lehtësimi i përdorimit të këtyre shërbimeve nga tatimpaguesit e Administratës Tatimore;
- » Sigurimi i një informacioni të plotë, të kuptueshëm në kohë dhe të aksesueshëm në lidhje me përmbushjen;
- » Zgjerimi i komunikimeve elektronike ndërmjet klientëve dhe Administratës Tatimore;
- » Studimi i nivelit të pritshmërisë dhe kënaqësisë së tatimpaguesve nga shërbimet e ofruara me qëllim zhvillimin e shërbimeve të reja si dhe përmirësimin e atyre ekzistuese;
- » Zhvillimi i shërbimeve duke u mbështetur në kërkesat, mundësitë dhe sjelljen e grupeve të ndryshme të tatimpaguesve;
- » Lehtësimi i procedurave dhe kërkesave administrative për tatimpaguesit e Administratës Tatimore, duke marrë në konsideratë ndër të tjera madhësinë e tyre si dhe thjeshtëzimin e deklaratave dhe formularëve;
- » Prezantimi dhe zhvillimi i një qasje, që do të inkurajojë përmbushjen vullnetare nga tatimpaguesit e rregullt të cilët jo qëllimisht bëjnë gabime, dhe zbatimi i mbledhjes me forcë ose vendosja e penaliteteve vetëm për ato tatimpagues të cilët qëllimisht nuk pajtohen me legjislacionin tatimor;
- » Të sigurojmë rimbursimin e TVSH-së sipas afateve të legjislacionit në fuqi
- » Sigurimi i shërbimeve elektronike për tatimpaguesit duke përdorur identifikimin elektronik.

Nën objektivi 1.2

Rritja e ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri.

- » Përf forcimi i rolit të komiteteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Administratës Tatimore, për të ndihmuar në zbatimin uniform të legjislacionit tatimor, si dhe për tu siguruar shërbime më të mira tatimpaguesve;
- » Organizimi i fushatave ndërgjegjëse për grupe specifike tatimpaguesish në mënyrë të tillë që të parandalohen gabimet ose mosveprimet në zbatimin e legjislacionit tatimor dhe për kontributet shoqërore;
- » Komunikim i vazhdueshëm dhe i orientuar ndaj publikut dhe grupeve të ndryshëm tatimpaguesish;
- » Bashkëpunim aktiv me median;
- » Të përgatitet dhe të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme një seri pyetje dhe përgjigje për publikim në faqen e internetit;
- » Shqyrtimi në kohë i propozimeve, njoftimeve dhe sinjaleve nga media me qëllim përmirësimin e aktivitetit të organizatës;
- » Transparencë më e madhe me publikun duke realizuar publikime të rregullta të performancës së Administratës Tatimore Qendrore;
- » Zhvillimi dhe zbatimi në arsimin e mesëm dhe të lartë i programeve të trajnimit që lidhen me kulturën tatimore dhe sigurimet shoqërore.

Nën objektivi 1.3

Zbatimi i metodologjive dhe praktikave njëhësuese

- » Hartimi i propozimeve për ndryshimet ligjore me qëllim thjeshtëzimin e sistemit tatimor;
- » Përshtatja e rregullave të brendshme të Administratës Tatimore për të lehtësuar përmbushjen nga ana e tatimpaguesve;
- » Hartimi dhe zbatimi i opinioneve metodologjike të përditësuara dhe në vazhdimësi për zbatimin uniform të legjislacionit;
- » Analizimi i çështjeve ligjore në lidhje me tatimet në mënyrë që të promovohen praktikat më të mira;
- » Përmirësimi i bashkëpunimit me Gjykatat Administrative;
- » Informimi i punonjësve të Administratës Tatimore në kohë reale për ndryshimet në legjislacionin tatimor dhe sigurimet shoqërore.

Objektivi Strategjik 2:

Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor

Nën objektivi 2.1

Zbatimi i strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut

- » Përmirësimi i analizës dhe vlerësimit të rreziqeve të rëndësishme të mosrespektimit të legjislacionit tatimor;
- » Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve sektoriale të përmbushjes dhe reduktimi i nivelit të riskut;
- » Zgjerimi i kapaciteteve për të ekzaminuar të dhënat nga burime të ndryshme gjatë analizës së riskut të përmbushjes së tatimeve;
- » Përdorimi i burimeve të informacionit nga palë të treta (Dogana, Banka, DPSHTRR etj); dhe sigurimi që çdo informacion të jetë i integruar në modelin e kontrollit duke u bërë një faktor për vlerësimin e rrezikut
- » Monitorimi i rregullt i niveleve të përmbushjes.
- » Forcimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimi i pandërprerë me bizneset duke synuar marrjen e një baze të plotë të dhënash

Nën objektivi 2.2

Përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore

- » Kontrolli tatimor i përqëndruar tek tatimpaguesit, risqet dhe sektorët ekonomikë të cilët kanë gjeneruar humbje të konsiderueshme në buxhetin e shtetit;
- » Zhvillimi i metodave të reja të analizimit të të dhënave në mënyrë elektronike gjatë kontrollit tatimor;
- » Mbështetja e përdorimit të gjerë të faturave elektronike;
- » Shtimi i formulave në modelin e kontrollit për të shtuar efektivitetin e tij në identifikimin e tatimpaguesve më rrezik
- » Zhvillimi i kapacitetit për monitorimin dhe kontrollin e transaksioneve elektronike;
- » Përmirësimi i kapaciteteve në kontrollin e produkteve me risk të lartë tatimor me qëllim verifikimin elektronik të të dhënave në zinxhirin e transaksioneve;
- » Përmirësimi i cilësisë së kontroleve. Përditësimi i procedurave të kontrollit për të siguruar kryerjen në kohë dhe në mënyrë standarde të tyre;
- » Zhvillimi i kapaciteteve për zbulimin e mashtrimeve tatimore nëpërmjet përdorimit dhe analizimit të informacioneve nga burime të ndryshme, si dhe krijimin e ekipeve të profilizuara;
- » Përdorimi i qasjes për parandalimin e mashtrimeve tatimorembështetur në monitorimin dhe komunikimin e vazhdueshëm me tatimpaguesit, në mënyrë që të stimulojnë korrigjimin vullnetar dhe në kohë të sjelljes jo të rregullt;
- » Ngritja e kapaciteteve të personelit të Drejtorisë së Kontrollit në DTM, mbi bazë të sektorëve të ekonomisë.
- » Rritja e bashkëpunimit me institucione të tjera ndërvepruese në gjurmimin e krimit tatimor.

Nën objektivi 2.3**Mbledhja efikase dhe efektive e borxhit**

- » Rritja e mundësive për analizën e të dhënave nga burime të ndryshme në vlerësimin e riskut të sjelljes së tatimpaguesve me detyrime të papaguara;
- » Trajtimi i mbledhjes së borxhit publik në përshtatje me sjelljen dhe llojin e detyrimit të papaguar të tatimpaguesve;
- » Përdorimi i metodave që do të sigurojnë pagesa vullnetare të detyrimeve të papaguara me qëllim shmangien e fillimit të zbatimit të masave shtrënguese;
- » Monitorimi i veçantë për ecurinë e stokut të borxhit dhe rishikimi i proceseve të mbledhjes me forcë
- » Zgjerimi i mëtejshëm në sistemin informatik tatimor të automatizimit të proceseve që kanë të bëjnë me mbledhjen e borxhit.

Objektivi Strategjik 3:**Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore****Nën objektivi 3.1****Aplikimi i metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një AT moderne**

- » Përmirësimi i planifikimit strategjik, buxhetimit, planifikimi operacional, menaxhimit të projekteve dhe planifikimit të burimeve;
- » Vlerësimi i rezultateve të punës së Administratës Tatimore dhe analizimi i shpenzimeve administrative (kostot operative);
- » Fillimi, zhvillimi cilësor dhe zbatimi i projekteve me financim të jashtëm me fokus në instrumentet financiare të Bashkimit Evropian;
- » Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit;
- » Zhvillimi dhe përdorimi i një sistemi të menaxhimit të performancës. Përmirësimi i sistemit të vetëvlerësimit mbështetur në modelin e ekselencës EFQM. Realizimi i ndryshimeve duke ndjekur ciklin Planifiko-Realizo-Kontrollo-Vepro;
- » Zhvillimi i një komunikimi të brendshëm dhe iniciativave për krijimin e frymës së besimit midis punonjësve të Administratës;
- » Shkëmbimi i eksperiencave, studimi dhe zbatimi i praktikave më të mira ndërkombëtare në lidhje me sistemet e menaxhimit;
- » Zbatimi i një programi të dedikuar për antikorrupsionin;
- » Përmirësimi i ambjentit për sigurinë fizike, duke zhvilluar sisteme moderne për sigurinë dhe kontrollin.

Nën objektivi 3.2**Zhvillimi i kapaciteteve dhe motivimi i punonjësve**

- » Zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi efikas për vlerësimin dhe shpërblimin e punonjësve sipas rezultateve të performancës;
- » Zhvillimi dhe mbajtja e një mjedisi pune që ngre besimin tek të punësuarit, motivimin dhe kënaqësinë në punë;
- » Përmirësimi dhe ruajtja e mirëqënies sociale të të punësuarve;
- » Zbatimi i programeve të trajnimit si për drejtuesit e sapo caktuar ashtu edhe për ata me përvojë.
- » Vlerësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të trajnimeve të tilla;
- » Përmirësimi i procesit të zhvillimit të karrierës dhe mundësive të ofruara;
- » Organizimi i drejtimit të nivelit të lartë në Administratën Tatimore.
- » Zhvillimi i programeve afatgjata për trajnime profesionale dhe zhvillimin e karrierës së punonjësve.

Nën objektivi 3.3**Mbajtja e proceseve optimale dhe struktura e Administratës Tatimore**

- » Përdorimi i një qasjeje sistematike për të zgjedhur dhe përshtatur strukturat apo proceset nëpërmjet analizës së efikasitetit dhe efektivitetit të ndryshimeve organizative, duke përfshirë analizat kosto-përfitim dhe matjen e efektivitetit nga zbatimi i këtyre ndryshimeve;
- » Zhvillimi i një sistemi për analizën efikase të drejtorive rajonale, duke përfshirë analizimin e rajoneve me kostot më të larta administrative;
- » Zhvillimi i sistemeve për menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke përfshirë rishikimin vjetor dhe përditësimin në kohë të urdhrave ekzistues, udhëzimeve, procedurave, rregullave mbi funksionimin dhe rregullat e tjera të Administratës Tatimore, në lidhje me zbatimin, mbivendosjen dhe cilësinë e tyre;
- » Organizimi i analizave të rregullta dhe periodike të performancës së Administratës Tatimore Qendrore për funksionet bazë dhe ndihmëse me qëllim identifikimin e mundësive për përmirësim;
- » Zhvillimi dhe zbatimi i standardeve lidhur me të gjithë aktivitetin e Administratës Tatimore;
- » Përmirësimi i cilësisë në sistemet informatike të Administratës Tatimore. Ngritja e një sistemi për të vlerësuar saktësinë e të dhënave të administruara nga Administrata Tatimore;
- » Kalimi drejt menaxhimit elektronik të dokumentave në përputhje me dispozitat ligjore;
- » Zhvillimi i infrastrukturës kompjuterike të Administratës Tatimore Qendrore dhe sistemeve të informacionit, në mënyrë që të sigurohet akses, besueshmëria dhe siguria e të dhënave dhe të informacionit.

Nën objektivi 3.4**Zhvillimi dhe përmirësimi i partneriteteve**

- » Zbatimi i një përfaqëse të strukturuar në lidhje me rishikimin, dhëniene prioriteteve, zgjerimin dhe përditësimin e partneriteteve të Administratës me autoritetet e tjera;
- » Rritja e ndërveprimit elektronik dhe shkëmbimit të informacionit me administratat e tjera, duke përfshirë modelin e shërbimeve administrative të integruara, si dhe pjesëmarrjen në projektet kombëtare;
- » Pjesëmarrja në zhvillimin si dhe rritja e kontributit të Administratës Tatimore Qendrore në veprimtaritë e E-Governance në Shqipëri;
- » Krijimi i bashkëpunimit dhe bashkëveprimit elektronik me shtetet anëtare të BE, institucionet e BE –së dhe me vendet e tjera;
- » Zbatimi efektiv i angazhimeve të Administratës në lidhje me pjesëmarrjen e saj në marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe në programet dhe marrëveshjet dypalëshe;
- » Pozicionimi i Administratës Tatimore në hartën botërore të Administratave Tatimore.

Nën objektivi 3.5**Modernizimi dhe rinovimi i ambienteve**

- » Sigurimi i kushteve të përshtatshme të punës dhe ambienteve moderne për punonjësit e Administratës;
- » Sigurimi i mjeteve të përshtatshme dhe profesionale të punës;
- » Ndërmarrja e veprimeve të nevojshme për kontrollin e përdorimit të energjive dhe pajisjes me çertifikata teknike të ambienteve në pronësi të Administratës. Marrja e masave të domosdoshme për të garantuar nivel të lartë të efikasitetit të përdorimit të energjisë duke reduktuar ndikimin mjedisor nëpërmjet reduktimit të konsumit të burimeve;
- » Përmirësimi i kapaciteteve të arkivave rajonale duke i pajisur me sisteme të automatizuara që do të lejojnë përdorimin maksimal të hapësirës duke rritur efikasitetin e menaxhimit të procesit të ruajtjes.

PJESA 3

TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS

Aneksi 1 - Treguesit kryesorë të performancës

Nr.	Treguesit
IP1	Zbatimi i planit vjetor të të ardhurave sipas llojit të të ardhurave.
IP2	Kosto e administrimit të tatimeve (lekë të shpenzuara për lekë të mbledhura).
IP3	Numri i deklaratave të dorëzuara në kohë nga individë.
IP4	Numri i deklaratave të dorëzuara në kohë nga sipërmarrje.
IP5	Niveli i kënaqësisë së tatimpaguesve në ndërveprimin me Administratën Tatimore (rezultatet e sondazheve).
IP6	Madhësia e hendekut tatimor sipas llojeve të risqeve.
IP7a	Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit – reduktimi i numrit të tatimpaguesve me risk.
IP7b	Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit – reduktimi i demit.
IP8	Numri i veprimeve, kontrolleve, në të cilën është përdorur analiza elektronike e të dhënave.
IP9	Numri i tatimpaguesve me borxh ndaj numrit total të tatimpaguesve.
IP10	Numri i tatimpaguesve që kanë paguar detyrimet tatimore renda afatit ligjor, ndaj numrit të përgjithshëm të tatimpaguesve që kanë deklaruar një detyrim.
IP11	Raporti i detyrimeve të paguara brenda afatit ndaj shumës së përgjithshme të detyrimeve të deklaruar.
IP12	Niveli i kënaqësisë së punonjësve kundrejt institucionit dhe drejtuesve (rezultatet nga anketimi i mbështetur në faktorët e motivimit).
IP13	Numri i çështjeve të apeluara ndaj numrit total të kontrolleve të kryera.
IP14	Numri i kontrolleve të hedhura poshtë pjesërisht ose plotësisht me vendim të formës së prerë ndaj numrit total të kontrolleve të ankimuara.
IP15	Numri i deklaratave të korrektuara si rezultat i veprimeve të kontrollit.
IP16	Numri i kontrolleve të kryera ndaj tatimpaguesve që kryejnë tregtinë elektronike.
IP17	Numri i njoftimeve të dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.
IP18	Numri i takimeve të mbajtura me tatimpaguesit me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.
IP19	Vleradhe numri i deklaratave të korrigjuara nga tatimpaguesit, si rezultat i njoftimeve të dërguara apo takimeve të mbajtura me ta.
IP20	Koha e procesimit të kërkesave për rimbursim
IP21	Numri total i taksapaguesve i asistuar (tel / ballë për ballë)
IP22	Numri total i klikimeve elektronike (internet, ecc)
IP23	Numri total i vizitave këshilluese të përfunduara
IP24	Numri i seminareve edukues të realizuar
IP25	Vlera e takses se vlerësuar nga Kontrolli (për tipologji kontrolli)
IP26	Vlera e paguar e taksës së aksesuar nga Kontrolli
IP27	Sa raste kontrolli janë referuar (muja) në Drejt. e Hetimit Tatimor (dhe vlera)
IP28	Numri i bizneseve të reja të regjistruara
IP29	Numri i individëve (punonjësve) të regjistruar

Aneksi 2 Lidhja e objektivave me rekomandimet e TADAT

Objektivi strategjik	Nën objektivi	Aktivitetet	Afati	Strukturat Përgjegjëse	Rekomandimi i TADAT
Garantimi i asistencës për përbushjen vullnetare	1.1. Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore	– Mirëmbajtja dhe zhvillimi i shërbimeve që i korrespondojnë teknologjisë moderne dhe lehtësimi i përdorimit të këtyre shërbimeve nga tatimpaguesit e Administratës Tatimore;	2021	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria Ligjore.	POA 3 “Mbështetja e pajtueshmërisë vullnetare” POA4 “Deklarimi në kohë i tatimeve” POA9 “Logaridhënia dhe transparenca”, “Perceptimi publik i integritetit”
		– Sigurimi i një informacioni të plotë, të kuptueshëm në kohë dhe të aksesueshëm në lidhje me përbushjen;	2017		
		– Zgjerimi i komunikimeve elektronike ndërmjet klientëve dhe Administratës Tatimore;	2018		
		– Studimi i nivelit të pritshmërisë dhe kënaqësisë së tatimpaguesve nga shërbimet e ofruara me qëllim zhvillimin e shërbimeve të reja si dhe përmirësimin e atyre ekzistuese;	NE VAZHDMESI		
		– Zhvillimi i shërbimeve duke u mbështetur në kërkesat, mundësitë dhe sjelljen e grupeve të ndryshme të tatimpaguesve;			
		– Lehtësimi i procedurave dhe kërkesave administrative për tatimpaguesit e Administratës Tatimore, duke marrë në konsideratë ndër të tjera madhësinë e tyre si dhe thjeshtëzimin e deklaratave dhe formularëve;			
		– Prezantimi dhe zhvillimi i një qasje, që do të inkurajojë përbushjen vullnetare nga tatimpaguesit e rregullt të cilët jo qëllimisht bëjnë gabime, dhe zbatimi i mbledhjes me forcë ose vendosja e penaliteteve vetëm për ato tatimpagues të cilët qëllimisht nuk pajtohen me legjislacionin tatimor;	2017		
		–	2018		
			– Te sigurojme rimbursimin e TVSH-se sipas afateve të legjislacionit në fuqi		

Objektivi strategjik	Nën objektivi	Aktivitetet	Afati	Strukturat Përgjegjëse	Rekomandimi i TADAT
	1.2. Rritja e ndërgjegjësitimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për pëmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri	<ul style="list-style-type: none">Përforcimi i rolit të komiteteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Administratës Tatimore, për të ndihmuar në zbatimin uniform të legjislacionit tatimor, si dhe për të siguruar shërbime më të mira tatimpaguesve;Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere për grupe specifike tatimpaguesish në mënyrë të tillë që të parandalohen gabimet ose mosveprimet në zbatimin e legjislacionit tatimor dhe për kontributet shoqërore;Komunikim i vazhdueshëm dhe i orientuar ndaj publikut dhe grupeve të ndryshëm tatimpaguesish;Bashkëpunim aktiv me median;Të përgatitet dhe të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme një seri pyetje dhe përgjigjeje për publikim në faqen e internetitShqyrtimi në kohë i propozimeve, njoftimeve dhe sinjaleve nga media me qëllim përmirësimin e aktivitetit të organizatës;Transparencë më e madhe me publikun duke realizuar publikime të rregullta të performancës së Administratës Tatimore Qendrore;Zhvillimi dhe zbatimi në arsimin e mesëm dhe të lartë i programeve të trajnimit që lidhen me kulturën tatimore dhe sigurimet shoqërore.	2017	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve	POA 3 “Mbështetja e pajtueshmërisë vullnetare” POA8 “Menaxhimi i frytshëm i të ardhurave” POA9 “Logaridhënia dhe transparencia”
			2017		
			NE VAZHDIMESI		
			2019		
	1.3. Zbatimi i metodologjive dhe praktikave njëhësuese	<ul style="list-style-type: none">Hartimi i propozimeve për ndryshimet ligjore me qëllim thjeshtëzimin e sistemit tatimor;Përshtatja e rregullave të brendshme të Administratës Tatimore për të lehtësuar përbushjen nga ana e tatimpaguesve;Hartimi dhe zbatimi i opinionëve metodologjike të përditësuara dhe në vazhdimësi për zbatimin uniform të legjislacionit;Analizimi i çështjeve ligjore në lidhje me tatimet në mënyrë që të promovohen praktikatat më të mira;Përmirësimi i bashkëpunimit me Gjykatat Administrative;Informimi i punonjësve të Administratës Tatimore në kohë reale për ndryshimet në legjislacionin tatimor dhe sigurimet shoqërore.	NE VAZHDIMESI	Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve	POA 7 “Zgjidhja e efektshme e mosmarrëveshjeve tatimore”, “Ekzistenca e një procesi të pavarur, funksional dhe të provuar të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”

Objektivi strategjik	Nën objektivi	Aktivitetet	Afati	Strukturat Përgjegjëse	Rekomandimi i TADAT
Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor	2.1. Zbatimi i strategjisë së përbushjes së menaxhimit të riskut	<ul style="list-style-type: none">Përmirësimi i analizës dhe vlerësimit të rreziqeve të rëndësishme të mosrespektimit të legjislacionit tatimor;	NE VAZHDIMESI	Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Rimbursimit, Drejtoria e Kontrollit, Drejtoria e Mbledhjes së Borxhit , Drejtoria e Hetimit Tatimor	POA 1 "Integriteti i bazës tatimpaguese të regjistruar" POA 2 "Menaxhimi efektiv i riskut"
		<ul style="list-style-type: none">Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve sektoriale të përbushjes, dhe reduktimi i nivelit të riskut;Zgjerimi i kapaciteteve për të ekzaminuar të dhënat nga burime të ndryshme gjatë analizës së riskut të përbushjes së tatimeve;Përdorimi i burimeve të informacionit nga palë të treta (Dogana, Banka, DPSHTRR etj); dhe sigurimi që çdo informacion të jetë i integruar në modelin e kontrollit duke u bërë një faktor për vlerësimin e rrezikut	2017 2018 2020		
		<ul style="list-style-type: none">Monitorimi i rregullt i niveleve të përbushjes.	NE VAZHDIMESI		
		<ul style="list-style-type: none">Forcimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimi i pandërprerë me bizneset duke synuar marrjen e një baze të plotë të dhënash	NE VAZHDIMESI		
	2.2. Përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore	<ul style="list-style-type: none">Kontroll tatimor i përqendruar tek tatimpaguesit, risqet dhe sektorët ekonomikë të cilët kanë gjeneruar humbje të konsiderueshme në buxhetin e shtetit;	2017	Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Kontrollit, Drejtoria e Hetimit Tatimor	POA 3 "Mbështetja e pajtueshmërisë vullnetare" POA 9 "Logaridhënia dhe transparencia"
		<ul style="list-style-type: none">Zhvillimi i metodave të reja të analizimit të të dhënave në mënyrë elektronike gjatë kontrollit tatimor;	2019		
		<ul style="list-style-type: none">Mbështetja e përdorimit të gjerë të faturave elektronike;	2018		
		<ul style="list-style-type: none">Shtimi i formulave në modelin e kontrollit për të shtuar efektivitetin e tij në identifikimin e tatimpaguesve më rrezik	2018		
		<ul style="list-style-type: none">Zhvillimi i kapacitetit për monitorim dhe kontrollin e transaksioneve elektronike;	2019		
		<ul style="list-style-type: none">Përmirësimi i kapaciteteve në kontrollin e produkteve me risk të lartë tatimor me qëllim verifikimin elektronik të të dhënave në zinxhirin e transaksioneve;	2019		
		<ul style="list-style-type: none">Përmirësimi i cilësisë së kontrolleve.Përditësimi i procedurave të kontrollit për të siguruar kryerjen në kohë dhe në mënyrë standarde të tyre;	2020		
		<ul style="list-style-type: none">Zhvillimi i kapaciteteve për zbulimin e mashtrimeve tatimore nëpërmjet përdorimit dhe analizimit të informacioneve nga burime të ndryshme, si dhe krijimin e ekipeve të profilizuara;	2018		
		<ul style="list-style-type: none">Përdorimi i qasjes për parandalimin e mashtrimeve tatimore mbështetur në monitorimin dhe komunikimin e vazhdueshëm me tatimpaguesit, në mënyrë që të stimulojnë korrigjimin vullnetar dhe në kohë të sjelljes jo të rregullt;	2017		
